

VENDIM
Nr.1508, datë 19.11.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR UNAZA SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.9836 datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Shkodër (kolektorët).
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1617 (një mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) m² tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 24 025 033 (njëzet e katër milionë e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e tre) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 24 025 033 (njëzet e katër milionë e njëzet e pesë mijë e tridhjetë e tre) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30 nëntor 2008 dhe të përfundojë më 30 dhjetor 2008.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Për pronarët, për të cilët është shënuar “Proces regjistrimi”, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do të bëjë likuidimin, pasi të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë.
 8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrat e pasurive, në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PERSONAVE, PRONAT E TË CILËVE PREKEN NGA REHABILITIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“UNAZA SHKODËR”

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Trashëgimtarët		Anemali	8591	8/824	truall	810	13429	10877490	Konfirmim
2	Trashëgimtarët		Lluja	8591	8/440	truall	400	13429	5371600	Konfirmim
3	Smajl	Caf	Shyti	8592	7/529	truall	13	21564	280332	Konfirmim
4	Shpresim	Nazif	Tola	8591	8/11	truall	40.5	13429	543874.5	Konfirmim
5	Hatixhe		Deltina	8592	7/566	truall	14	21564	301896	Konfirmim
6	Sabri		Hebovia	8592	7/87	truall	36	21564	776304	Konfirmim
7	Mersin	Ali	Jahja	8591	6/308	truall	103	21564	2221092	Konfirmim
8	Ahmet		Osja	8591	13/340	truall	5	13429	67145	Proces.regj.
9	Xhavid	Hamza	Jakupi	8591	13/375	truall	15.5	21564	334242	Konfirmim
10	Selaudin		Jakupi	8591	13/373	truall	9.5	21564	204858	Konfirmim
11	Fadil		Pirani	8591	5/89,5/88	truall	37	21564	797868	Proces.regj.
12	Haki		Hoxha	8591	3/301	truall	16	21564	345024	Konfirmim
13	Nazmi		Kruja	8591	6/739	truall	45.5	13429	611019.5	Konfirmim
14	Medi		Duda	8591	6/616	truall	25	21564	539100	Konfirmim
15	Petrit		Barbullushi	8591	8/435	truall	32	13429	429728	Konfirmim
16	Kujtim		Ferhati	8591	6/761	truall	5	21564	107820	Konfirmim
17	Ahmet		Osja	8591	13/343	truall	10	21564	215640	Konfirmim
	Shuma						1617		24025033	

